



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 30 nëntor 2021
Nr. ref.:RK 1908/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI173/20

Parashtrues

Yusuf Timurhan

**Vlerësim i kushtetutshmërisë
së Aktgjyimit të Gjykatës Supreme të Kosovës,
Rev.nr.392/19, të 2 qershorit 2020**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Yusuf Timurhan nga Komuna e Prizrenit, të cilin e përfaqëson avokati Miftar Qelaj nga Prizreni (në tekstin e mëtejshmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin [Rev. nr. 392/19] e 2 qershorit 2020, të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin në vijim: Gjykata Supreme), në lidhje me Aktgjykimin [Ac.nr.3309/16] e 3 korrikut 2019, të Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin në vijim: Gjykata e Apelit) dhe Aktgjykimin [C.nr.329/15] e 8 qershorit 2016, të Gjykatës Themelore në Prizren (në tekstin në vijim: Gjykata Themelore).
3. Aktgjykimin e kontestuar parashtruesi i kërkesës e kishte pranuar me 10 korrik 2020.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, përmes së cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë e tij themelore të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin në vijim: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 (E Drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin në vijim: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale), të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura para Gjykatës

6. Më 10 nëntor 2020, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi përmes e-mailit kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin në vijim: Gjykata).
7. Më 17 nëntor 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Selvete Gërzhaliu-Krasniqi dhe Gresa Caka-Nimani (anëtare).
8. Më 1 dhjetor 2020, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës.
9. Më 1 dhjetor 2020, Gjykata njoftoi Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës dhe të njëjtës i dërgoi një kopje të kërkesës.
10. Më 15 prill 2021, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore që të dorëzojë fletëkthesën, e cila dëshmon se kur parashtruesi i kërkesës e kishte pranuar Aktgjykimin e kontestuar.

11. Më 29 prill 2021, Gjykata Themelore e dorëzoi në Gjykatë fletëkthesën, që dëshmon se parashtruesi i kërkesës e kishte pranuar Aktgjykimin e kontestuar më 10 korrik 2020.
12. Më 29 prill 2021, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore dorëzimin e dosjes së plotë.
13. Më 12 maj 2021, Gjykata Themelore e dorëzoi dosjen në Gjykatë.
14. Më 27 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi në përbërjen e Kolegjit shqyrtues gjyqtarin Nexhmi Rexhepi në vend të gjyqtarit Bekim Sejdiu i cili ka dhënë dorëheqje me 25 maj 2021.
15. Më 4 qershor 2021, Gjykata njoftoi Avokaturën Shtetërore, Qeverinë e Kosovës, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Policinë e Kosovës në cilësi të palës së interesuar, për regjistrimin e kërkesës dhe të njëjtës i dërgoi një kopje të kërkesës.
16. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin 4 të Rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani mori detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.
17. Më 22 korrik 2021, Kolegji Shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe me shumicë rekomandoi plotësimin e rastit.
18. Më 10 nëntor 2021, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

19. Më 15 maj 2009, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, përmes Vendimit [11/SP/DP/2009], përcaktoi që policët e suspenduar me pagesë nuk gëzojnë të drejtën në shtesa tjera përveç pagës bazë.
20. Më 22 gusht 2009, Policia e Kosovës përmes Njoftimit [KRH-02-086/09] suspendoi parashtruesin e kërkesës i cili ishte polic në Policinë e Kosovës, me pagesë të plotë. Suspendimi i parashtruesit zgjati deri më 15 maj 2011.
21. Nga shkresat e lëndës rezulton që Prokuroria Komunale kishte paraqitur aktin akuzues [PP.nr. 874/12] të 28 dhjetorit 2009, kundër parashtruesit të kërkesës për shkak të veprës penale moslajmërimi i veprave penale apo moslajmërimi i kryerësve të veprave penale nga neni 304 paragrafi 1 të Kodit Penal të Kosovës.
22. Më 3 maj 2011, Policia e Kosovës përmes Njoftimit [09/NSP/DP/2011] e ndërpreu suspendimin me pagesë të parashtruesit të kërkesës, me arsyetimin se ishte vërtetuar se nuk ekziston dyshimi i arsyeshëm për vepër penale, prandaj kërkon nga ai paraqitjen në vendin e punës duke filluar nga 16 maji 2011.

23. Nga shkresat e lëndës rezulton që gjatë periudhës së suspendimit me pagesë, parashtruesi i kërkesës kishte pasur disa ndalesa në të ardhura personale ku përfshiheshin pagesa në emër të rrezikshmërisë, shtesat, si dhe kompensimi i pushimit vjetor.
24. Më 14 qershor 2012, Gjykata Komunale në Prizren përmes Aktvendimit [P.nr. 554/11] pushoi procedurën penale kundër parashtruesit të kërkesës lidhur me veprën penale moslajmërimi i veprave penale apo moslajmërimi i kryerësve të veprave penale nga neni 304 paragrafi 1 të Kodit Penal të Kosovës, pas tërheqjes së Prokurorisë nga ndjekja penale.
25. Më 20 shkurt 2014, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar në Drejtorinë e Personelit të Policisë së Kosovës kërkesë për kompensim të shtesave në pagë nga 22 gushti 2009 e deri me 15 maj 2011, lidhur me periudhën kohore të suspendimit me pagesë sipas vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës.
26. Më 22 shtator 2014, Drejtoria e Personelit e Policisë së Kosovës përmes *"përgjigjes në kërkesë e datës 20.02.2014"* [07/1/421/20147], refuzoi kërkesën e parashtruesit me arsyetimin se ndalesat për shtesat në pagë janë bërë sipas vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës [11/SP/DP/2009] të 15 majit 2009, ku theksohej që të gjithë policët e suspenduar me pagesë, nuk gëzojnë shtesa tjera përveç pagës bazë.
27. Më 11 shkurt 2015, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar ankesë në Komisionin për Ankesa dhe Shpërblime në Policinë e Kosovës duke kërkuar aprovimin e pagesës së të gjitha beneficioneve gjatë kohës së suspendimit me pagesë. I njëjti theksonte që kjo e drejtë i takonte pasi me Aktvendimin [P.nr.554/11] e 14 qershorit 2012, të Gjykatës Komunale në Prizren, ishte pushuar procedura penale ndaj tij dhe rrjedhimisht ishte shpallur i pafajshëm.
28. Më 26 shkurt 2015, Komisioni për Ankesa dhe Shpërblime i Policisë së Kosovës përmes Vendimit [010-KA-A-2015] hodhi poshtë ankesën e parashtruar jashtë afatit ligjor nga ana e parashtruesit të kërkesës.. Në arsyetimin e Vendimit, Komisioni për ankesa dhe shpërblime i Policisë së Kosovës theksoi që parashtruesi i kërkesës me 22 shtator 2014, kishte pranuar përgjigjen nga Drejtoria e Personelit, kurse ankesën ndaj përgjigjes e ka adresuar në Komisionin për Ankesa dhe Shpërblime më 11 shkurt 2015, për afërsisht katër muaj me vonesë, në kundërshtim me nenin 96, paragraf 1, pika 1.2, të Udhëzimit Administrativ nr. 07/2012 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, ku theksohet: *"Personeli i Policisë i cili konsideron se me vendimin administrativ i është shkelur ndonjë e drejtë nga marrëdhënia e punës, ka të drejtë të paraqes ankesë në organin e shkallës së dytë e cila i dërgohet drejtpërdrejt Komisionit për Ankesa dhe Shpërblime apo përmes zinxhirit komandues brenda afatit prej 15 ditësh"*.
29. Më 20 mars 2015, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar padi në Gjykatën Themelore në Prizren (në tekstin në vijim: Gjykata Themelore) ndaj të paditurës Qeveria e Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme - Policia e Kosovës, duke theksuar se i njëjti kërkon që t'ia kompensojnë dhe paguajnë të gjitha ndalesat në të ardhura personale në kohën e suspendimit, përkatësisht që nga 22 gushti

2009 deri me 15 maj 2011 dhe atë të ardhurat në emër të të ardhurave shtesë mbi pagën bazë.

30. Më 27 mars 2015, Policia e Kosovës dorëzoi përgjigjen në padi përmes së cilës kërkonte nga Gjykata Themelore që e njëjta ta mohonte si të palejuar padinë e parashtruesit të kërkesës, sepse i njëjti kishte kërkuar mbrojtje gjyqësore pas kalimit të afatit ligjor.
31. Më 8 qershor 2016, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [C.nr.329/15] (i) aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, dhe obligoi Qeverinë e Kosovës, Ministrinë e Punëve të Brendshme - Policinë e Kosovës, që t'ia kompensojë dhe paguajë diferencën në të ardhura personale për periudhën 22 gusht 2009 deri me 15 maj 2011, në lartësi prej 3,303.58 euro, me kamatë ligjore si për mjetet e afatizuara mbi një vit pa destinim të caktuar, duke filluar prej ditës së marrjes së këtij aktgjykimi, e deri te pagesa definitive, të gjitha në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi; (ii) Obligoi të paditurën që t'ia paguajë shpenzimet procedurale parashtruesit të kërkesës dhe atë në lartësi prej 675.40 euro, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë; (iii) Refuzoi si të pabazuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë së parashtruesit të kërkesës, mbi shumat e aprovuara si në pikën I të dispozitivit, e deri në shumën e përgjithshme të kërkuar prej 4,523.35 euro.
32. Më 15 gusht 2016, Avokatura Shtetërore e cila përfaqësonte Policinë e Kosovës në cilësi të palës së interesuar, parashtroi ankesë për shkak të (i) shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore; (ii) konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike; dhe (iii) aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin e ndryshimit të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, duke e hedhur poshtë kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës si të palejuar.
33. Më 3 korrik 2019, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac.nr.3309/16] refuzoi si të pathemeltë ankesën e palës së interesuar: Qeveria e Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme – Policia e Kosovës, ndërsa vërtetoi Aktgjykimin [C.nr.329/15] e Gjykatës Themelore.
34. Më 28 gusht 2019, pala e interesuar- Qeveria e Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme - Policia e Kosovës, parashtroi kërkesë për revizion kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, për shkak të: (i) shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore; dhe (ii) zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që aktgjykimet e Gjykatës Themelore dhe të Apelit të ndryshohen, ashtu që padia e parashtruesit të kërkesës të hidhej si e palejuar. Në kërkesë për revizion pala e interesuar theksonte që parashtruesi i kërkesës kishte kërkuar mbrojtje gjyqësore pas afatit ligjor, përkatësisht i njëjti kishte parashtruar ankesë kundër përgjigjes në kërkesë [07/1/421/20147] të 22 shtator 2014, të Drejtorisë së Personelit të Policisë së Kosovës, më 11 shkurt 2015, pra diku rreth katër (4) muaj me vonesë.
35. Më 16 tetor 2019, nga shkresat e lëndës përkatësisht fletëkthesa, rezulton që parashtruesi i kërkesës kishte pranuar kërkesën për revizion të parashtruar nga pala e interesuar. Parashtruesi i kërkesës nuk parashtroi përgjigje në kërkesën për revizion.

36. Më 2 qershor 2020, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev.nr.392/19] pranoi si të bazuar revizionin e palës së interesuar, Qeveria e Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme-Policia e Kosovës dhe ndryshoi aktgjykimin e Gjykatës Themelore [C.nr.329/2015] të 8 qershorit 2016 dhe aktgjykimin [AC.nr.3309/2016] e 3 korrikut 2019, të Gjykatës së Apelit, duke gjykuar si vijon: Refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, me të cilën është kërkuar që të detyrohet pala e interesuar, Qeveria e Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme-Policia e Kosovës, që parashtruesit të kërkesës t'ia paguaj diferencën në të ardhura personale, për periudhën prej 22 gushtit 2009 e deri më 15 maj 2011, në lartësi prej 3,303.58€, me kamatë si për mjetet e deponuara në kursim, të afatizuara për më tepër se një vit, pa destinim të caktuar, duke filluar nga dita e marrjes së aktgjykimit (8 qershor 2016) e deri te pagesa definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 675.40€; secila palë i heqë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

37. Në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme arsyeton si në vijim:

“Sipas kësaj Gjykate, gabimisht është zbatuar e drejta materiale dhe konkretisht Ligji i Punës, për faktin se paditësi është suspenduar më 22 gusht 2009 dhe ky suspendim ka zgjatë deri me 15 maj 2011, kur e paditura e ndërprente suspendimin e paditësit dhe e kthen në punët dhe detyrat e mëparshme, ndërsa ka ushtruar padi me 20 mars 2015. Mbrojtja gjyqësore në rastin konkret është e pasafateshme për shkaqet që lidhen me nenin 87 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, ku është paraparë se të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës, çka do të thotë se në rastin konkret ka kaluar afati i paraparë me nenin e cekur më lartë, andaj sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, gjykatat e instancës më të ulët në mënyrë të gabuar kanë zbatuar dispozitat e nenit 78 par.1 e 2 dhe nenit 79 të Ligjit të Punës së Kosovës që kanë të bëjnë me mbrojtjen gjyqësore nga marrëdhënia e punës. Prandaj edhe udhëzimi juridik i dhënë në përfundim të procedurës pranë të paditurës, është i gabuar dhe nuk e arsyeton vonesën e paditësit. Në nenin 87 të Ligjit të Punës parashihet që kërkesat në para që lidhen me marrëdhënien e punës parashkruhen në afat prej 3 vitesh nga dita e paraqitjes së kërkesës. Në rastin konkret prej momentit që paditësi u kthyer në punë e deri në ditën e paraqitjes së padisë kanë kaluar më tepër se 3 vjet, andaj rezulton se kërkesa e paditësit për kompensim të ardhurave personale është parashkruar.”

“Gjykata Supreme nuk e pranon si të ligjshëm qëndrimin e të dy gjykatave për shkak se duke konsideruar se mospagesa e të ardhurave personale është fitim i humbur, i cili paraqet edhe dëm të shkaktuar paditësit nga ana e të paditurës, vlerëson se kërkesa e tillë e paditësit është parashkruar duke u bazuar në dispozitën e nenit 376 par. 1 të LMD-së që parashihet se "Kërkesa e shpërblimit të dëmit të shkaktuar parashkruhet për tre vjet nga data kur i dëmtuari ka mësuar për dëmin dhe për personin që e ka bërë dëmin". Në rastin konkret prej ditës së suspendimit me 20 gusht 2009 e deri më 20 mars 2015 kur paditësi ka paraqitur padi në gjykatë kanë kaluar mbi pesë vjet dhe prej asaj kohe paditësi e ka ditur për dëmin dhe për shkaktarin. Kështu mbi këtë bazë kërkesa është parashkruar dhe mbrojtja gjyqësore

është e vonuar, sepse paditësi ka pas mundësi të kërkojë mbrojtje gjyqësore pavarësisht vonesave në përgjigje të kërkesës së tij."

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

38. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, [Rev.nr.392/19] i 2 qershorit 2020, është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të garantuara përmes nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.
39. Fillimisht, parashtruesi i kërkesës pretendon se: (i) nuk është njoftuar për zhvillimin e procedurës në Gjykatën Supreme të Kosovës, rrjedhimisht atij nuk i është mundësuar të paraqes pretendimet dhe kundërshtimet në lidhje me kërkesën për revizionin të parashtruar nga pala e interesuar.
40. Në vijim, parashtruesi i kërkesës pretendon që: (ii) në këtë rast është shqyrtuar revizioni edhe pse me ligj ka qenë i ndaluar në bazë të nenit 211 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, sepse vlera e kontestit sipas padisë ishte 500 euro, ndërsa kontesti nuk ishte filluar kundër vendimit për shuarjen mbi marrëdhënien e punës, prandaj në këtë rast revizioni nuk ka qenë i lejuar.
41. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon që Gjykata Supreme ka vendosur për refuzimin e padisë (iii) për shkak të parashkrimit të kërkesës, mirëpo për këtë pala e interesuar nuk ishte thirrur në përgjigje në padi gjatë tërë procedurës së shkallës së parë dhe as në ankesën e paraqitur kundër aktgjykimit të shkallës së parë. Pra, më tej ai pretendon se nuk kishte njohuri se çka përmbante kërkesa për revizion e parashtruar nga pala e interesuar, pasi që sipas tij të njëjtën nuk e posedonte, si rezultat i mosdorëzimit. Përkundër kësaj, parashtruesi i kërkesës thekson se bazuar në dispozitat e ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimore, përkatësisht neni 341 paragrafi 3 *"Gjykata nuk mund të marrë parasysh parashkrimin, në qoftë se debitori nuk thirret në atë."* Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës pretendon se në asnjë rast në procedurën gjyqësore që ka paraprirë nxjerrjen e aktgjykimit të kontestuar, pala e interesuar nuk është thirrur në parashkrim, rrjedhimisht gjykata ka vendosur lidhur me parashkrimin pa e ngritur këtë çështje pala e interesuar.
42. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese që të (i) shpallë kërkesën të pranueshme; (ii) të konstatojë se Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin [Rev.nr.392/19] të 2 qershorit 2020, ka shkelur të drejtat dhe liritë themelore të parashtruesit të kërkesës, përkatësisht nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe nenit 54 (Mbrojtja gjyqësore e të drejtave) të Kushtetutës; si dhe (iii) të shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin [Rev.nr.392/19] e 2 qershorit 2020, të Gjykatës Supreme të Kosovës.

Dispozitat përkatëse kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

[...]

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj

[...]

Neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]

Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6

(E drejta për një proces të rregullt)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtojte interesat e drejtësisë.
(...)

Ligji Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore

KREU XIV

MJETET E JASHTËZAKONSHME TË GODITJES

REVIZIONI

Neni 211

211.1 Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, palët mund të paraqesin revizion brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën u është dorëzuar aktgjykimi.

211.2 Revizioni nuk lejohet në kontestet pasurore-juridike në të cilat kërkesëpadia ka të bëjë me kërkesat në të holla, me dorëzimin e sendit, ose me përmbushjen e ndonjë premtimi tjetër, po që se vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit nuk i kalon 3.000 Euro.

211.3 Revizioni nuk lejohet në kontestet pasurore-juridike në të cilat kërkesëpadia nuk ka të bëjë me kërkesat në para, me dorëzimin e sendit apo me përmbushjen e ndonjë premtimi tjetër, po që se vlera e objektit të kontestit e treguar në padinë e paditësit nuk e kalon shumën prej 3.000 Euro.

211.4 Përfundimisht edhe kur është fjala për kërkesëpadinë nga paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, revizioni gjithmonë është i lejuar:

a) në kontestet për ushqim;

b) në kontestet për shpërblimin e dëmit për ushqimin e humbur, për shkak të vdekjes së dhënësit të ushqimit;

c) në kontestet nga marrëdhëniet e punës të cilat i fillon i punësuar kundër vendimit për shuarjen e marrëdhënies së punës.

Ligji Mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve 1978

KAPTINA 4 PARASHKRIMI

Kaptina 1 DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Rregulla e përgjithshme

Neni 360

Me parashkrimin pushon e drejta e kërimit të përmbushjes së detyrimit.

Parashkrimi lind kur të ketë kaluar afati i caktuar me ligj brenda të cilit kreditori ka mundur të kërkojë përmbushjen e detyrimit.

Gjykata nuk mund të përfillë parashkrimin në qoftë se debitori nuk e ka invokuar atë.

Kërkesa e shpërblimit të dëmit Neni 376

Kërkesa e shpërblimit të dëmit të shkaktuar parashkruhet për tre vjet nga data kur i dëmtuari ka mësuar për dëmin dhe për personin që e ka bërë dëmin.

Sidoqoftë kjo kërkesë parashkruhet për pesë vjet nga data kur është krijuar dëmi.

Kërkesa e shpërblimit të dëmit të krijuar nga cenimi i detyrimit kontraktues parashkruhet për kohën e caktuar për parashkrimin e këtij detyrimi.

Ligji Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (publikuar më 19.06.2012 dhe hyn në fuqi më 19.12.2012)

KREU 4 PARASHKRIMI

NËNKREU 1

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 341 Rregullat e përgjithshme

- 1. Me parashkrim shuhet e drejta e kërimit të përmbushjes së detyrimit.*
- 2. Parashkrimi krijohet kur të ketë kaluar afati i caktuar me ligj, brenda të cilit kreditori ka mundur të kërkojë përmbushjen e detyrimit.*
- 3. Gjykata nuk mund të merr parasysht parashkrimin, në qoftë se debitori nuk thirret në atë.*

Ngritja e padisë

Neni 388

Parashkrimi ndërpritet me ngritjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarrë kundër debitorit para gjykatës ose organit tjetër kompetent me qëllim përcaktimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës.

Ligji Nr. 03/L-212 i Punës

KREU IX Proceduarat për Realizimin e të drejtave nga Marrëdhënia e Punës

Neni 78 Mbrojtja e të drejtave për të punësuarit

- 1. I punësuar i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqesë kërkesë te punëdhënësi apo*

organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të shkelura.

2. Punëdhënësi është i obliguar për të vendosur sipas kërkesës së të punësuarit, në afatin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimi të kërkesës.

3. Vendimi nga paragrafi 2. i këtij neni, i dorëzohet të punësuarit në formë të shkruar brenda afatit prej tetë (8) ditësh.

Neni 79 Mbrojtja e të punësuarit në Gjykatë

Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente.

Neni 87 Afati i parashkrimit

Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

43. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.

44. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

45. Gjykata më tej i referohet kriterëve të pranueshmërisë, siç specifikohen në Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet), të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
(Kërkesa individuale)

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individidi mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
(Afatet)

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor[...].”

46. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata fillimisht thekson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [Rev.nr.392/19] e 2 qershorit 2020, të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me Ligj. Parashtruesi i kërkesës, gjithashtu, i ka qartësuar të drejtat dhe liritë që pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
47. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të parapara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtoj kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Konkretisht, rregulli 39 (2) përcakton që:

“Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

48. Rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ) dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

49. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “*qartazi e pabazuar*” në tërësinë e saj ose vetëm përkritazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si “*pretendime qartazi të pabazuara*”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime “*të shkallës së katërt*”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*”; (iii) pretendime “*të pambështetura apo të paarsyetuara*”; dhe në fund, (iv) pretendime “*konfuze dhe të paqarta*”. (Shih, më saktësisht për konceptin e papranueshmërisë mbi bazën e një kërkesë të vlerësuar si “*qartazi të pabazuar*”, dhe specifikat e katër kategorive të lartcekura të pretendimeve të kualifikuara si “*qartazi të pabazuara*”, Udhëzuesin Praktik të GJEDNJ-së për Kriteret e Pranueshmërisë të 28 shkurtit 2021; pjesën III. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat qartazi të pabazuara, paragrafët 279 deri më 308).
50. Në këtë kontekst, dhe në vijim, me qëllim të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, në rrethanat e këtij rasti, vlerësimit nëse e njëjta është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
51. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 54 [Mbrotja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.
52. Në këtë kontekst, Gjykata fillimisht rikujton që rrethanat e rastit ndërlidhen me kërkesën e parashtruesit të kërkesës për kompensimin e shtesave në pagë për periudhën sa ishte i suspenduar (nga 22 gushti 2009 deri më 15 maj 2011) drejtuar Drejtorisë së Personelit të Policisë së Kosovës, pasi që Prokuroria ishte tërhequr nga ndjekja penale dhe Gjykata Komunale përmes Aktvendimit kishte pushuar procedurën ndaj tij. Këtë kërkesë të parashtruesit, më 22 shtator 2014, e refuzoi Drejtoria e Personelit e Policisë së Kosovës. Në vijim, më 15 shkurt 2015, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar ankesë në Komisionin për Ankesa dhe Shpërblime në Policinë e Kosovës, ankesë të cilën ky Komision e hodhi poshtë nën arsyetimin se e njëjta ishte parashtruar jashtë afatit ligjor. Në vijim, Gjykata Themelore e kishte aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, të paraqitur kundër palës së interesuar, përkatësisht Qeverisë së Kosovës, Ministrisë së Punëve të Brendshme - Policisë së Kosovës, që t’ia kompensojë dhe paguajë diferencën në të ardhura personale për periudhën 22 gusht 2009 deri me 15 maj 2011, në lartësi prej 3,303.58 euro, me kamatë ligjore si për mjetet e afatizuara mbi një vit pa destinim të caktuar. Duke vepruar sipas ankesës përkatëse të palës së interesuar, Gjykata e Apelit, refuzoi si të pathemeltë ankesën e saj, ndërsa vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore. Ndaj Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, pala e interesuar kishte parashtruar kërkesë për revizion, e cila nga Gjykata Supreme pranohet si e

bazuar, si dhe ndryshohen Aktgjykimi i Gjykatës Themelore dhe Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, duke gjykuar si vijon: Refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës, me të cilën ishte kërkuar që të detyrohej pala e interesuar, Qeveria e Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme-Policia e Kosovës, që atij t'ia paguaj diferencën në të ardhura personale, për periudhën prej 22 gushtit 2009 e deri më 15 maj 2011, në lartësi prej 3,303.58€.

53. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës, para Gjykatës pretendon se përmes Vendimit të kontestuar i shkelen të drejtat e tij të garantuara me: (i) nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejt dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së; si dhe pretendimet për shkelje të nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

I) Lidhur me shkeljet e pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së

54. Parashtruesi i kërkesës, para Gjykatës ka ngritur tri pretendime kryesore lidhur me shkeljet e pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës: (i) se nuk e ka pranuar kërkesën për revizion të parashtruar nga pala e interesuar, rrjedhimisht nuk kishte mundësi që të paraqiste kundërshtimet e tij lidhur me përmbajtjen e kësaj kërkesë; (ii) revizioni nuk ishte i lejuar në këtë rast në bazë të nenit 211 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, sepse vlera e kontestit sipas padisë ishte 500 euro, ndërsa kontesti nuk ishte filluar kundër vendimit për shuarjen mbi marrëdhënien e punës; dhe (iii) pretendimi që Gjykata Supreme ka vendosur për refuzimin e kërkesëpadisë së tij për shkak të parashkrimit të kërkesës, pa e ngritur këtë çështje pala e interesuar.
55. Në lidhje me këtë, Gjykata, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por duke marrë parasysh edhe karakteristikat e saj, siç përcaktohen në KEDNJ, si dhe parimin e subsidiaritetit dhe doktrinën e shkallës së katërt, vazhdimisht ka theksuar ndryshimin midis “kushtetutshmërisë” dhe “ligjshmërisë” dhe ka theksuar se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e fakteve ose interpretimin e gabuar dhe zbatimin e gabuar të ligjeve, që pretendohet të jenë bërë nga një gjykatë e rregullt, përveç dhe për aq sa gabimet e tilla kanë mundur të shkelin të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë dhe/ose KEDNJ (shih në këtë kontekst rastet e Gjykatës KI128/18, Parashtrues: *Limak Kosovo International Airport J.S.C.*, “Adem Jashari”, Aktvendim i 28 qershorit 2019, paragrafi 55; KI62/19, parashtrues: *Gani Gashi*, Aktvendim për papranueshmëri i 19 dhjetorit 2019, paragrafët 56-57; KI110/19, parashtrues: *Fisnik Baftijari*, Aktvendim për papranueshmëri i 7 nëntorit 2019, paragrafi 40).
56. Gjykata gjithashtu vazhdimisht ka theksuar se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë gjetjet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe se nuk mund të vlerësojë vetë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “shkallës së katërt”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. (Shih: në këtë drejtim, rastin e GJEDNJ-së *García Ruiz kundër Spanjës*, aktgjykimi i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe referencat e përdorura atje; dhe

shih gjithashtu rastet KI128/18, të cituara më sipër, paragrafi 56; dhe KI62/19, të cituar më lart, para 58).

57. Gjykata vëren se thelbi i pretendimeve të parashtruesit të kërkesës ka të bëjë me vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike dhe interpretimin e gabuar të ligjeve të zbatueshme nga Gjykata Supreme. Gjykata vëren se Gjykata Supreme arsyeton në mënyrë të detajuar se në bazë të cilave prova dhe në bazë të të cilave dispozita materiale ka nxjerrë aktgjykimin përkatës, duke iu përgjigjur pretendimeve të parashtruesit të kërkesës lidhur me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale.

(i) Lidhur me pretendimin e mospranimit të kërkesës për revizion të parashtruar nga pala e interesuar

58. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon se nuk është njoftuar për zhvillimin e procedurës në Gjykatën Supreme të Kosovës, rrjedhimisht atij nuk i është mundësuar të paraqesë pretendimet dhe kundërshtimet në lidhje me kërkesën për revizionin e parashtruar nga pala e interesuar.

59. Lidhur me pretendimin e lartcekur, Gjykata vëren se në arsyetimin e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme është theksuar se nuk pati përgjigje në revizion. Për më tepër, Gjykata thekson se në dosje të lëndës ekziston fletëkthesa e cila dëshmon që kërkesa për revizion është pranuar nga përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës, më 16 tetor 2019.

60. Rrjedhimisht, përderisa parashtruesi i kërkesës e ka pranuar në mënyrë të rregullt revizionin, i njëjti nuk e shfrytëzoi të drejtën e tij që të parashtronte përgjigje në revizion para Gjykatës Supreme, prandaj ky pretendim i parashtruesit të kërkesës është qartazi i pabazuar.

(ii) Lidhur me pretendimin se revizioni nuk ishte i lejuar në rastin konkret

61. Gjykata në vijim rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendonte që në rastin konkret është shqyrtuar revizioni edhe pse me ligj ka qenë i ndaluar në bazë të nenit 211 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, sepse vlera e kontestit sipas padisë ishte 500 euro, ndërsa kontesti nuk ishte filluar kundër vendimit për shuarjen mbi marrëdhënien e punës, prandaj në këtë rast sipas tij revizioni nuk ka qenë i lejuar.

62. Në vijim, lidhur me pretendimin lartcekur të parashtruesit të kërkesës, Gjykata thekson që paragrafi 2 i nenit 211 të Ligjit për Procedurën Kontestimore përcakton që: *“Revizion nuk lejohet në kontestet pasurore-juridike në të cilat kërkesëpadia ka të bëjë me kërkesat në të holla, me dorëzimin e sendit, ose me përmbushjen e ndonjë premtimi tjetër, po që se vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit nuk i kalon 3.000 Euro”*.

63. Rrjedhimisht, në rastin konkret Gjykata vëren se revizioni i parashtruar nga pala e interesuar u ushtrua në procedurën në të cilin vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të Aktgjykimit, ishte shuma 3,303.58 euro. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson që kufiri minimal i kërkuar nga kjo dispozitë ligjore është

përmbushur. Prandaj, ky pretendim i parashtruesit të kërkesës është po ashtu qartazi i pabazuar.

(iii) Lidhur me pretendimin se Gjykata Supreme ka vendosur për refuzimin e kërkesëpadisë për shkak të parashkrimit të kërkesës, pa e ngritur këtë çështje pala e interesuar

64. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon që Gjykata Supreme ka vendosur për pranimin e revizionit të palës së interesuar, me ç' rast ka rezultuar me refuzimin e kërkesëpadisë së tij për shkak të parashkrimit të kërkesës, mirëpo për këtë pala e interesuar nuk ishte thirrur në përgjigje në padi gjatë tërë procedurës së shkallës së parë dhe as në ankesën e paraqitur kundër aktgjykimit të shkallës së parë. Pra, më tej ai pretendon se nuk kishte njohuri se çka përmbante kërkesa për revizion e parashtruar nga pala e interesuar, pasi që sipas tij të njëjtën nuk e posedonte, si rezultat i pretendimit të tij se e njëjta nuk i ishte dorëzuar.

65. Lidhur me këtë pretendim të parashtruesit të kërkesës, Gjykata fillimisht rikujton që çështja e parashkrimit ishte trajtuar nga gjykatat e rregullta që nga marrja e Aktgjykimit [C.nr.329/15] të Gjykatës Themelore, e cila në arsyetimin e saj theksonte:

“Po ashtu edhe në nenin 87 të ligjit të punës është e paraparë se të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës, e që sipas, vlerësimit të gjykatës kërkesa e paditësit ka qenë e parashtruar brenda afatit ligjor të paraparë sipas kësaj dispozite andaj dhe vendosi si në dispozitiv.”

66. Gjykata vëren se në kërkesën për revizion të Avokaturës Shtetërore, e njëjta kërkonte nga Gjykata Supreme që kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës të refuzohet si e palejuar me ligj: pasi që përmes saj parashtruesi i kërkesës kërkonte mbrojtje gjyqësore pas kalimit të afatit të paraparë ligjor, brenda të cilit kishte mundur të kërkonte mbrojtje gjyqësore.

67. Gjithashtu, Gjykata rikujton nenin 341 të Ligjit Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve që përcakton se *“gjykata nuk mund të marrë parasysh parashkrimin kur debitori nuk thirret në të”*. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se në kërkesën për revizion të Avokaturës Shtetërore, kjo e fundit nuk ishte thirrur në refuzim të kërkesëpadisë të parashtruesit mbi bazën e parashkrimit, por megjithatë kishte ngritur specifikisht çështjen e mbrojtjes gjyqësore pas kalimit të afatit të paraparë ligjor.

68. Rrjedhimisht, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev.nr.392/19] të 2 qershorit 2020, pranoi si të bazuar revizionin e të paditurës duke konstatuar se gabimisht ishte zbatuar e drejta materiale nga gjykatat e shkallës më të ulët, pasi që parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur mbrojtje gjyqësore jashtë afatit ligjor. Ndër tjerash, Gjykata Supreme theksoi si në vijim arsyet e pranimi të revizionit:

“Sipas kësaj Gjykate, gabimisht është zbatuar e drejta materiale dhe konkretisht Ligji i Punës, për faktin se paditësi është suspenduar më 22 gusht 2009 dhe ky suspendim ka zgjatë deri me 15 maj 2011, kur e paditura

e ndërprejnë suspendimin e paditësit dhe e kthen në punët dhe detyrat e mëparshme, ndërsa ka ushtruar padi me 20 mars 2015. Mbrojtja gjyqësore në rastin konkret është e pasafateshme për shkaqet që lidhen me nenin 87 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, ku është paraparë se të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës, çka do të thotë se në rastin konkret ka kaluar afati i paraparë me nenin e cekur më lartë, andaj sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, gjykatat e instancës më të ulët në mënyrë të gabuar kanë zbatuar dispozitat e nenit 78 par.1 e 2 dhe nenit 79 të Ligjit të Punës së Kosovës që kanë të bëjnë me mbrojtjen gjyqësore nga marrëdhënia e punës. Prandaj edhe udhëzimi juridik i dhënë në përfundim të procedurës pranë të paditurës, është i gabuar dhe nuk e arsyeton vonesën e paditësit. Në nenin 87 të Ligjit të Punës parashihet që kërkesat në para që lidhen me marrëdhënien e punës parashkruhen në afat prej 3 vitesh nga dita e paraqitjes së kërkesës. Në rastin konkret prej momentit që paditësi u kthyer në punë e deri në ditën e paraqitjes së padisë kanë kaluar më tepër se 3 vjet, andaj rezulton se kërkesa e paditësit për kompensim të ardhurave personale është parashkruar.”

69. Prandaj, duke marrë për bazë të lartcekurat, Gjykata konstaton që parashtuesi i kërkesës ka pasur mundësi të përfitojë nga procedura kontradiktore dhe se ka pasur mundësi që në fazat e ndryshme të procedurës t'i paraqesë pretendimet dhe provat të cilat i ka konsideruar si të rëndësishme për rastin e tij; ka pasur mundësinë për t'i kundërshtuar në mënyrë efektive pretendimet dhe provat e paraqitura nga pala kundërshtare; gjykatat e rregullta i kanë dëgjuar dhe shqyrtuar të gjitha pretendimet e tyre, e të cilat, shikuar objektivisht, kanë qenë të rëndësishme për zgjidhjen e lëndës, dhe se arsyet faktike dhe juridike për vendimin e kundërshtuar janë paraqitur në detaje, dhe për këtë arsye procedura, e marrë në tërësi, ishte e drejtë (shih: *mutatis mutandis*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 21 janarit 1999, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, paragrafët 29 dhe 30; shih gjithashtu rastin e Gjykatës KI22/19, parashtues *Sabit Ilazi*, aktvendim i 7 qershorit 2019, paragrafi 42 si dhe rastin e Gjykatës KI128/18, i cituar më lart, paragrafi 58).
70. Gjykata thekson që në rrethanat e rastit konkret, parashtuesi i kërkesës, përtej pretendimeve për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si rezultat i interpretimit të gabuar të ligjit, për shkak se gjykatat e rregullta kanë zbatuar ligjin “*në dëm të këtij parashtuesi të kërkesës*”, nuk mbështet mjaftueshëm dhe as nuk argumenton para Gjykatës, se si ky interpretim i ligjit të aplikueshëm nga gjykatat e rregullta, mund të ketë qenë “*qartazi i gabuar*”, duke rezultuar në “*konkluzione arbitrare*” apo “*qartazi të paarsyeshme*” për parashtuesin e kërkesës, apo se si procedurat pranë gjykatave të rregullta, në tërësinë e tyre, mund të mos kenë qenë të drejta apo edhe arbitrare. Përveç kësaj, Gjykata vlerëson se gjykatat e rregullta kanë marrë parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat e rastit, pretendimet e parashtuesit të kërkesës dhe kanë arsyetuar qartazi të njëjtat (Shih: në këtë drejtim, rastin e Gjykatës KI64/20, parashtues: *Asllan Meka*, Aktvendim për papranueshmëri i 3 gushtit 2020, paragrafi 41 dhe KI22/19, cituar më lart, paragrafi 43).
71. Përfundimisht, Gjykata konkludon se pretendimet e parashtuesit të kërkesës për shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me

nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së për shkak të interpretimit të gabuar dhe aplikimit të gabuar të ligjit të zbatueshëm janë (i) pretendime që bien në kategorinë e “*shkallës së katërt*” dhe si të tilla, këto pretendime të parashtruesit të kërkesës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

72. Prandaj, këto pretendime janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese dhe shpallen të papranueshme, siç përcaktohet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe specifikohet më tej me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

(II) Në lidhje me pretendimin për shkelje të nenit 54 të Kushtetutës

73. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës gjithashtu thekson që vendimi i kontestuar është nxjerrë në kundërshtim me të drejtat e garantuara me nenin 54 [Mbrotjtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.
74. Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës pretendon që aktgjykimi i Gjykatës Supreme, “*në mënyrë arbitrare*” ka shkelur të drejtat e tij individuale dhe ka ardhur deri te shkelja e nenit 54 të Kushtetutës, mirëpo i njëjti, nuk shpjegon specifikisht se si ka ardhur deri te shkelja e këtij neni të Kushtetutës. Lidhur me këtë, Gjykata rikujton se ajo ka theksuar vazhdimisht se vetëm referimi dhe përmendja e neneve të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, në këtë kontekst, rastet KI175/20, me parashtrues: *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për Papranueshmëri i 22 prillit 2021, paragrafi 81; KI166/20 cituar më lart, paragrafi 52; KIO4/21, me parashtruese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri i 11 majit 2021, paragrafët 38- 39).
75. Andaj, Gjykata konstaton se sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 54 të Kushtetutës, kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar, sepse ky pretendim cilësohet si pretendim që i takon kategorisë së pretendimeve “*të pambështetura ose të paarsyetuara*”, pasi parashtruesi i kërkesës thjesht ka cituar një dispozitë të Kushtetutës dhe KEDNJ-së, pa shpjeguar se si është shkelur ajo. Prandaj, ky pretendim është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

Përfundim

76. Në fund, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës është e papranueshme, sepse (I) pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së përkritazi me pretendimet e parashtruesit të kërkesës (i) se nuk e ka pranuar kërkesën për revizion të parashtruar nga pala e interesuar, rrjedhimisht nuk kishte mundësi që të paraqiste kundërshtimet e tij lidhur me përmbajtjen e kësaj kërkesë; (ii) revizioni nuk ishte i lejuar në këtë rast në bazë të nenit 211 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, sepse vlera e kontestit sipas padisë ishte 500 euro, ndërsa kontesti nuk ishte filluar kundër vendimit për shuarjen mbi marrëdhënien e punës; dhe (iii) pretendimi që

Gjykata Supreme ka vendosur për refuzimin e kërkesëpadisë së tij për shkak të parashkrimit të kërkesës, pa e ngritur këtë çështje pala e interesuar; janë pretendime që kualifikohen si pretendime “të shkallës së katërt”; dhe si të tilla këto pretendime të parashtruesit të kërkesës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese; dhe (II) pretendimi i parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 54 të Kushtetutës, është qartazi i pabazuar, sepse i njëjti cilësohet si pretendim që i takon kategorisë së pretendimeve “të pambështetura ose të paarsyetuara”. Prandaj, kërkesa në tërësi duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenit 20 të Ligjit dhe të rregullave 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 10 nëntor 2021, njëzëri:

VENDOS

- I. TË SHPALLË kërkesën të papranueshme;
- II. T’UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Bajram Ljuti



Gresa Caka Nimani